MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data: 13.10.26 Nr.: 2936

Bazuar në Nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenin 7 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit si dhe Kapitullin III të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Kompaninë Rajonale Ujësjellësi Mitrovica" Sh. A Nr. 2453, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, sot me datë 13.10.2026 shpallë këtë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS:

Punë provuese gjashtë (6) muaj me mundesi vazhdimi

Institucioni:	**Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A.**
Pozita e punës:	**Inxhinier/e përgjegjës/e i/e Elektroenergjetikës**
Departamenti:	**Teknik**
Numri i pozitave të hapura:	**1**
Vendi i Punës:	**Mitrovicë (1)**
Kohëzgjatja e Kontratës:	**Me afat të pacaktuar**
Periudha Provuese:	**Puna provuese 6 (gjashtë) muaj**
Orari i Punës:	**I plotë**
Paga Bazë:	**950 euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".**

Konkursi do të jetë i hapur për pesëmbëdhjetë **(15)** ditë nga dita e publikimit, duke filluar nga data **13.10.2026** deri më **27.10.2026** në orën **16:00.**

Brenda afatit prej **shtatë (7) ditëve**, nga data e shpalljes së konkursit, kandidatët e interesuar mund të paraqesin **pyetje apo kërkesa për sqarime** lidhur me shpalljen e konkursit në formë të shkruar përmes email zyrtar:

✉ burimet.njerzore@kru-mitrovica.com

PËRSHKRIMI I DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË PUNËS:

- Përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e mirëmbajtjes elektrike të gjitha pajisjeve dhe sistemeve në impiante dhe stacione të pompave që janë nën menaxhimin e kompanisë.
- Harton dhe zbaton plane javore dhe mujore për inspektim dhe mirëmbajtje parandaluese në të gjitha stabilimentet elektrike.
- Planifikon nevojat për material rezervë në bashkëpunim me udhëheqësin e njësisë dhe përgatit kërkesat për furnizim.
- Harton dhe menaxhon oraret e punës për pompistët në stacione dhe mbikëqyr respektimin e tyre.
- Mban evidenca ditore dhe mujore të punës së stafit të mirëmbajtjes elektrike dhe pompistëve dhe raporton tek shefi i njësisë.
- Ndërhyn teknikisht në zgjidhjen e defekteve dhe në realizimin e ndërhyrjeve korrigjuese, në përputhje me prioritetin dhe urgjencën.
- Siguron zbatimin e standardeve të sigurisë teknike gjatë punës në sisteme elektrike.
- Bashkëpunon ngushtë me menaxherin/shefin e njësisë dhe me inxhinierët e tjerë në vendimmarrjen teknike për çështjet elektromakinerike.
- Raporton rregullisht për gjendjen teknike të pajisjeve dhe nevojat për investime ose përmirësime në sistemet elektrike.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit.
- Raporton te Shefi i Mirëmbajtjës së Elektro - Makinerisë.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME:

Kandidati/ja duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme si më poshtë:

- Duhet të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
- Të mos jetë dënuar me më shumë se gjashtë (6) muaj burgim me vendim të formës së prerë;
- Të dëshmojë se është i aftë për punë;
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi me menaxhmentin e kompanisë;
- Të njohë punën me kompjuter, veçanërisht programet MS Office;
- Njohja e dygjuhësisë (Shqipe-Serbe) do të konsiderohet përparësi.

II. KUSHTET E VEÇANTA:

Shkollimi : Fakulteti Teknik - Drejtimi Elektroenergjetikë/Elektroteknik

Përvoja e punës: Së paku 2 vite përvojë relevante në fushën e elektroenergjetikës ose mirëmbajtjes elektrike industriale.

III. DOKUMENTET E KËRKUARA:

Kandidatët e interesuar duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:

- **Aplikacionin zyrtar të KRU "Mitrovica",** i cili mund të shkarkohet në ueb-faqen zyrtare të kompanisë në adresën: www.kru-mitrovica.com/konkurset;
- **CV-në (biografia);**
- **Kopjen e vlefshme të letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës;**
- **Dëshmia lidhur me shkollimin (Diploma):**

- Sipas kritereve të përcaktuara, kërkohet kopje e noterizuar e diplomës. Në rast se kandidati nuk e ka paraqitur kopjen e noterizuar gjatë aplikimit, është i obliguar ta dorëzojë para nënshkrimit të kontratës.
- Në rastet kur diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës ose dëshminë se diploma e fituar është në procedurë nostrifikimi, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.
- Për diplomat e lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, duhet të paraqitet vërtetimi për verifikim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë dhe Invocacionit (MAShTI) ose dëshmia e aplikimit për verifikim, me kusht që verifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.

- **Certifikatën nga evidenca penale,** jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj, që dëshmon se kandidati nuk është dënuar me më shumë se gjashtë (6) muaj burgim me vendim të formës së prerë.
- **Certifikatën mjekësore lidhur me aftësinë për punë -** jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj, e cila dorëzohet në rast të punësimit;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (trustin pensional, kontratë pune ose vërtetim nga punëdhënësi për funksionin apo detyrat e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimit me të cilën dëshmon përvojë relevante në fushën e elektroenergjetikës ose mirëmbajtjes elektrike industriale).

IV. MËNYRA E APLIKIMIT:

Aplikacioni, së bashku me dokumentet përcjellëse sipas pikës III, duhet të dorëzohen fizikisht, në selinë e Kompanisë, në sportelin e pranim-dorëzimeve gjatë orarit të rregullt të punës.

V. DATA E PUBLIKIMIT TË REZULTATEVE TË VLERËSIMIT PARAPRAK:

Vetëm Kandidatët që plotësojnë kushtet për pjesëmarrje testim me shkrim dhe pastaj në intervistë me gojë do të njoftohen individualisht përmes email-it burimet.njerzore@kru-mitrovica.com në linjë me afatet e përcaktuara në Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit.

VI. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE/APLIKANTËVE:

Për këtë pozitë, kandidatët vlerësohen në dy (2) faza:

Faza e parë

- **Testimi me Shkrim** – deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me peshë **gjashtëdhjetë përqind (60%)**;

Faza e dytë:

- **Jetëshkrimi (CV)** – deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me **dhjetë përqind (10%)**; dhe
- **Intervista** – deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me **tridhjetë përqind (30%).**

VII. MËNYRA E NJOFTIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME KANDIDATËT:

Të gjitha komunikimet me kandidatët do të bëhen vetëm përmes emailit të rekrutimit elektronik: burimet.njerzore@kru-mitrovica.com

VËREJTJE:

Aplikacionet e dorëzuara **pas afatit të përcaktuar** nuk do të pranohen.

Aplikacionet e paplotësuara ose aplikacionet që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e kërkuara, do të refuzohen dhe nuk do t'u nënshtrohen procedurës të mëtejme të vlerësimit.

Kandidatët që dështojnë të paraqiten në ndonjërën **nga fazat e vlerësimit pa arsye**, konsiderohet se kanë hequr dorë nga konkursi.

KRU "Mitrovica" Sh.A

MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Ligenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data/ 13.10.26 Nr.: 2936

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03/L-212, člana 7. Pravilnika o postupku zapošljavanja i poglavlja III Pravilnika o Sistematizaciji Radnih Mesta u Kompaniji Regionalni Vodovod „Mitrovica" D.D. br. 2453, Kompanija Regionalni Vodovod „Mitrovica" D.D. u Mitrovici, danas, 13.10.2026 godine, objavljuje sledeći:

KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA:

Probni rad u trajanju od šest (6) meseci sa mogućnošću produženja

Institucija:	**Kompanija Regionalni Vodovod "Mitrovica" D.D.**
Radno mesto:	**Inženjer/ka odgovoran/na za elektroenergetiku**
Odeljenje:	**Tehničko**
Broj otvorenih radnih mesta:	**1**
Mesto rada:	**Mitrovica (1)**
Trajanje ugovora:	**Na neodređeno vreme**
Probni period:	**Probni rad u trajanju od 6 (šest) meseci**
Radno vreme:	**Puno radno vreme**
Osnovna plata:	**950 evra, prema Pravilniku o raspodeli prihoda KRU "Mitrovica".**

Konkurs će biti otvoren petnaest (**15**) dana od dana objavljivanja, počev od **13.10.2026** do **27.10.2026** u **16:00** časova.

U roku od **sedam (7) dana** od dana objavljivanja konkursa, zainteresovani kandidati mogu podneti **pitanja ili zahteve za pojašnjenje** u vezi sa objavom konkursa u pisanoj formi putem zvanične email adrese:

✉ burimet.njerzore@kru-mitrovica.com

OPIS POSLOVA I ODGOVORNOSTI:

- Odgovoran/a za organizovanje i upravljanje električnim održavanjem svih uređaja i sistema u postrojenjima i pumpnim stanicama pod upravom kompanije.
- Priprema i sprovodi nedeljne i mesečne planove za inspekciju i preventivno održavanje u svim električnim instalacijama.

- Planira potrebe za rezervnim materijalom u saradnji sa rukovodiocem jedinice i priprema zahteve za snabdevanje.
- Priprema i upravlja rasporedima rada za operatere pumpi na stanicama i nadgleda njihovo poštovanje.
- Vodi dnevnu i mesečnu evidenciju o radu osoblja za elektro održavanje i operatera pumpi i izveštava šefa jedinice.
- Tehnički interveniše u rešavanju kvarova i u sprovođenju korektivnih intervencija, u skladu sa prioritetom i hitnošću.
- Obezbeđuje sprovođenje tehničkih bezbednosnih standarda pri radu na električnim sistemima.
- Usko sarađuje sa menadžerom/šefom jedinice i drugim inženjerima u donošenju tehničkih odluka o elektromehaničkim pitanjima.
- Redovno izveštava o tehničkom stanju opreme i potrebama za investicijama ili poboljšanjima električnih sistema.
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovodioca.
- Izveštava Šefu održavanja elektro-mašinske opreme.

I. OPŠTI USLOVI:

Kandidat/kinja mora da ispunjava sledeće opšte uslove:

- Mora biti državljanin/ka Republike Kosovo;
- Mora imati navršenih osamnaest (18) godina;
- Ne sme biti osuđivan/a na kaznu zatvora dužu od šest (6) meseci pravosnažnom sudskom presudom;
- Mora dokazati da je sposoban/a za rad;
- Mora imati odlične komunikacione i saradničke veštine sa menadžmentom kompanije;
- Poznavanje rada na računaru, posebno MS Office programa;
- Poznavanje dvojezičnosti (albanski-srpski) smatraće se prednošću.

II. POSEBNI USLOVI:

Obrazovanje: Tehnički Fakultet – Smer Elektroenergetika/Elektrotehnika

Radno iskustvo: Minimum 2 godine relevantnog iskustva u oblasti elektroenergetike ili industrijskog električnog održavanja.

III. POTREBNA DOKUMENTACIJA:

Zainteresovani kandidati treba da prilože sledeće dokumente:

- **Zvaničnu prijavu KRU "Mitrovica"**, koja se može preuzeti sa zvaničnog sajta kompanije: www.kru-mitrovica.com/konkurset;
- **CV (biografiju);**
- **Važeću kopiju lične karte izdate od strane Republike Kosovo;**
- **Dokaz o obrazovanju (Diploma):**
  - Prema utvrđenim kriterijumima, traži se overena kopija diplome. Ako kandidat nije priložio overenu (noterizovanu) kopiju prilikom prijave, obavezan je da je dostavi pre potpisivanja ugovora.
  - Ukoliko je diploma stečena u inostranstvu, potrebno je priložiti potvrdu o nostrifikaciji diplome ili dokaz da je diploma u procesu nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome dostavi najkasnije do trenutka potpisivanja ugovora.
  - Za diplome izdate od Univerziteta Severne Mitrovice, potrebno je priložiti potvrdu Ministarstva prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacije (MPNTI/MAShTI) ili dokaz o podnošenju zahteva za verifikaciju, pod uslovom da se verifikacija diplome dostavi najkasnije do trenutka potpisivanja ugovora.

- **Uverenje iz krivične evidencije,** ne starije od šest (6) meseci, koje dokazuje da kandidat nije osuđen na više od šest (6) meseci zatvora pravosnažnom presudom.

- **Lekarsko uverenje o sposobnosti za rad** – ne starije od šest (6) meseci, koje se dostavlja u slučaju zaposlenja;

- **Dokaz o radnom iskustvu** (potvrda Penzionog trusta, ugovor o radu ili potvrda poslodavca kojom se dokazuje radna funkcija ili dužnosti i trajanje angažovanja, kojom se dokazuje relevantno iskustvo u oblasti elektroenergetike ili industrijskog električnog održavanja).

IV. NAČIN PRIJAVE:

Prijava, zajedno sa pratećom dokumentacijom iz tačke III, mora se dostaviti fizički, u sedištu Kompanije, na šalteru za prijem i predaju dokumenata, tokom redovnog radnog vremena.

V. DATUM OBJAVE REZULTATA PRELIMINARNE PROCENE:

Samo kandidati/kinje koji ispunjavaju uslove za učešće na pismenom testiranju, a zatim na usmenom intervjuu biće pojedinačno obavešteni putem emaila burimet.njerzore@kru-mitrovica.com u skladu sa rokovima utvrđenim u Pravilniku o postupku zapošljavanja.

VI. NAČIN OCENJIVANJA KANDIDATA/APLIKANATA:

Za ovu poziciju, kandidati se ocenjuju u dve (2) faze:

Prva faza

- **Pismeno testiranje** - do sto (100) poena pomnoženo ponderom od **šezdeset procenata (60%)**

Druga faza:

- **Biografija (CV)** - do sto (100) poena pomnoženo ponderom **od deset procenata (10%)**
- **Intervju** - do sto (100) poena pomnoženo ponderom od **trideset procenata (30%).**

VII. NAČIN OBAVEŠTAVANJA I KOMUNIKACIJE SA KANDIDATIMA

Sva komunikacija sa kandidatima će se obavljati isključivo putem elektronske email adrese za regrutovanje: burimet.njerzore@kru-mitrovica.com

NAPOMENA:

Prijave dostavljene **nakon navedenog roka** neće biti prihvaćene.

Nepotpune prijave ili prijave kojima nisu priloženi svi traženi dokumenti biće odbijene i neće biti predmet daljeg postupka ocenjivanja.

Kandidati koji se **bez opravdanog razloga ne pojave u bilo kojoj fazi ocenjivanja,** smatraće se da su odustali od konkursa.

KRU"Mitrovica" D.D